



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-056

Prishtinë, më 26 mars 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 26 MARS 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Millosavleviq dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj

Nga OSBE-ja, Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 mars 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 mars 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 mars 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 29 mars 2012, me këtë

R e n d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bibliotekat në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuessve,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lojërat e fatit,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fondet pensionale në Kosovë,
9. Kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tërheqjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-168 për turizmin dhe shërbimet turistike,
10. Shqyrtimi Planit Hapësinor i Zonës me interes të veçantë "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë dhe Divjakë",

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Ndërsa, lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Pronës, Kryesia nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni për Legjislacion që të rishqyrtojë rekomandimin lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Pronës, për kandidatin Ismajl Osdautaj, në vërejtjet e dhëna për kriterin e moshës së pensionimit dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Njoftimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri

Kryesia u njoftua me vizitën e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, të realizuar në Shqipëri, prej 19 deri më 21 shkurt 2012.

3.2 Raporti i parë për zbatimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropiane, për vitin 2012

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me raportin e lartpërmendur, vendosi që kjo pikë të radhitet në rend dite të mbledhjes tjetër plenare.

4. Të ndryshme:

4.1 Vlerësimi i performancës të sekretarit të Kuvendit, Ismet Krasniqi

Kryetari paraqiti vlerësimin e performancës për punën e sekretarit të Kuvendit, Ismet Krasniqi. Ai në vlerësimin e performancës së sekretarit tha se Administrata e Kuvendit, nën autoritetin e sekretarit të Kuvendit, gjatë periudhës së kaluar, ka ofruar: shërbime profesionale, teknike, administrative, si dhe shërbimet tjera mbështetëse për Kuvendin.

Sekretari i Kuvendit, si udhëheqës kryesor i administratës së Kuvendit, gjatë kësaj periudhe ka treguar: profesionalizëm, efikasitet, paanshmëri dhe përgjegjësi të lartë në organizimin dhe mbështetjes e punës së trupave të Kuvendit, të komisioneve parlamentare, të Kryesisë dhe seancave plenare.

Propozimin e kryetarit e mbështetën të gjithë nënkryetarët e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, mori këtë

V E N D I M

Sekretarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ismet Krasniqi, i vazhdohet kontrata e punës deri më 31 korrik 2015.

4.2 Nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, para Kryesisë së Kuvendit, ngriti çështjen e funksionimit të raporteve ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës. Ai këtë e ilustroi me praninë e kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, në mbledhjen e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, gjatë shqyrtimit të Projektligjit për Hoqën e Madhe.

Lidhur për këtë çështje diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **12:10** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale